

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Botoxi kontrabandë, Gremi i pandehur, çfarë ndodh me Farian? - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/botoxi-kontrabande-gremi-i-pandehur-cfare-ndodh-me-farian/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:24:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:20:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e636c3a55945d1bbc71205f4b61c993ec6868d2eb3831cee7b232fba37592932
TEKSTI	b6c76f6b68bd21ab81ce8b89a0f25f5bf8fcded06282ebaf88ddc48c74c1710b
PAMJA	ffb3f249ceb08d723375fd563cf74bf7048e834d6c8a585e106cd51541fea5d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	14e48a86402e87002e8dd301f002007ef963aca6520194cf7563582765e4d408
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/14e48a86402e87002e8dd301f002007ef963aca6520194cf7563582765e4d408

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Botoxi kontrabandë, Gremi i pandehur, çfarë ndodh me Farian?

AKTUALITET

Demo

Botoxi kontrabandë, Gremi i pandehur, çfarë ndodh me Farian?

SEPTEMBER 17, 2026



Biznesmeni Dritan Gremi është marrë i pandehur së bashku me shoqërinë "Gremi Wellness" në kuadër të dosjes së botoksit kontrabandë, hetim që lidhet me operacionin "Botulinum Toxin" të zhvilluar nga autoritetet në tetor të vitit 2024.

Sipas raportimeve në media, çështja ndodhet aktualisht në fazën e seancës paraprake në Gjykatën e Tiranës, ndërsa seanca e radhës është planifikuar më 22 shtator 2026.

Sipas të dhënave të bëra publike, Gremi dhe shoqëria "Gremi Wellness" dyshohet se kanë futur në Shqipëri produkte "Botox" me princip aktiv "Botulinum toxin", të cilat nuk ishin të pajisura me autorizim për tregtim në vend.

Në kuadër të hetimit janë marrë në shqyrtim edhe pajisje mjekësore të pacertifikuara, të cilat janë konstatuar gjatë kontrollit në ambientet e "Gremi Clinic".

Hetimi për këtë çështje lidhet me operacionin "Botulinum Toxin", të zhvilluar nga autoritetet në tetor të vitit 2024. Në atë kohë, autoritetet kryen kontrolle në rreth 30 klinika estetike dhe parukeri në Tiranë, pas dyshimeve se në këto ambiente përdorej botoks i paregjistruar dhe i paautorizuar për tregtim në Shqipëri.

Gjatë kontrolleve u sekuestruan produkte me toksinë botulinike, ndërsa hetimi u fokusua te mënyra e furnizimit dhe shpërndarjes së tyre në klinika estetike.

Në kuadër të operacionit u shpallën në kërkim tre persona, mes tyre edhe mjeku Skerdi Faria, ndërsa raportohet se për këtë të fundit është pushuar çështja.

Faria, administrator i klinikës "Keit", u shpall në kërkim nën dyshimet se ishte i përfshirë në aktivitetin e lidhur me përdorimin e botoksit të paregjistruar. Në atë kohë nuk dihej nëse ai ndodhej në Shqipëri apo jashtë vendit, ndërsa mjeku nuk kishte bërë një reagim publik lidhur me shpalljen e tij në kërkim.

Pas gati dy vitesh nga operacioni, i pandehur për rastin është marrë Gremi dhe shoqëria "Gremi Wellness", ndërsa Skerdi Faries i është pushuar çështja. Kështu, mjeku që në tetor 2024 ishte shpallur në kërkim në kuadër të dosjes, tashmë nuk do të përballet me akuzat duke i shpëtuar drejtësisë.

policia Tiranë

SHARE.

Postimet e reja

**Botoxi kontrabandë,
Gremi i pandehur, çfarë...**

SEPTEMBER 17, 2026

**Besfort Lamallari u lirua
nga detyra, presidenti...**

SEPTEMBER 17, 2026

**Pesë interpelanca në rend
dite, Kuvendi vendos...**

SEPTEMBER 17, 2026

**Dyshohet se abuzuan me
një 12-vjeçare në Tiranë,...**

SEPTEMBER 17, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

**Kompania e krijuar tri ditë pas
hapjes së thirrjes për grantet e
startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në
fazën e rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare**

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant
2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

**Skema sesi IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që
ju merr konsumatorëve
me interesa mbi 30%!****Skandal me sallamin në
dyqanet Conad, thirrje
konsumatorëve ta kthejnë
mbarsht****6 milionë euro të Startup
Albania: Përfituesit, qokat
dhe "problematikët"**

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu